
STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“K & H CONSULTING” SH.P.K

Kreu I

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 01/02/2023, une, themeluesi, kam vendosur për të krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “K & H CONSULTING” SHPK.

Themelues i shoqërisë është:

1. **Znj. Jeta HYSA**, i datelindjes 17.10.1985, lindur në qytetin e Gramshit, Shqipëri dhe banuese në Tiranë, në adresë: Rruga Muhareme Butka, Pallati Rinia 04, Shk B, Ap 22, Njesia Administrative Nr 5, shtetase shqiptar, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, e identifikuar me kartë identiteti, të leshuar nga Ministria e Brendshme me nr. I 56017042 Q, me vullnet të lire, të plote si themeluese e kesaj shoqërie në të cilën jam ortakë e vetme.

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

- Shërbimet në fushën e kontabilitetit, atë të keshillimit financiar, përgatitje, analize pasqyrave financiare, asistencë dhe mbrojtje fiskale dhe doganore.
- Shërbim dhe konsulence mbrojtjes ligjore, avokatisë dhe gjyqësore.
- Pjesëmarrja direkte dhe indirekte në të gjithë operacionet financiare, me qëllim përmbushjen e objektivit të saj, për pasuritë e patundshme si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie marrje me qira, aktivitete këto që kanë aftësinë të favorizojnë zgjerimin dhe zhvillimin e saj.
- Shërbime të ndryshme ndaj institucioneve shërbim ofruese, aplikime deklarime të ndryshme.
- Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet, plotësohet modifikohet me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 3

Forma Ligjore

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyrë përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji i Shoqërive Tregtare”), dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5
Kohëzgjatja e Veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria krijohet për të vepruar për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në QKB-ne, Tiranë. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mundet të mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh e arsyeshme apo në raste të parashikuara në ligj.

Neni 6
Selia/Adresa e Regjistruar

- 6.1 Shoqëria “**K & H CONSULTING**” SHPK” sh.p.k do ta ketë selinë e saj në qytetin e Tiranës, Rruga Muhamet Gjollësja, Pallati Tirana Ring Center, Hyrja 1, Apartamenti 9, Tiranë.
- 6.2 Administratori, në përputhje me kompetencat që i jep statuti mund të hapë adresë sekondare të shoqërisë që kanë lidhje vetëm me aktivitetin e përcaktuar në Nenin 2, “Objekti i veprimtarisë”.

KREU II

Neni 7
Kapitali themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100 000 (*njëqindmijë*) Lekë.
- 7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1 pjesë (kuota) me vlerë nominale 100 000 (*njëqindmijë*) Lekë.
- 7.3 Kuotat do të zoterohen nga ortaku i vetëm.

Neni 8
Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave.
- 8.2 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Do t'u ofrohen për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Nëse kuotat e reja do tu ofrohen për nënshkrim një pale të tretë atëherë duhet miratimi me Shumicë të Cilësuar i Asamblesë së Ortakëve.

8.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financimeve me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Në rastet kur shoqëria do të gjendet përballë rasteve të nevojshme për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet financimit të ortakëve të shoqërisë, atëherë ortakët angazhohen të kryejnë financimet përkatëse.

8.4 Në rastin kur një ortak kundërshton parashikimin e mësipërm, atëherë asambleja e ortakëve do të procedojë me zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të Ligjit, ndërkohë që ortakut që nuk merr pjesë në financim i zbritet përqindja që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë.

8.5 Pavarësisht sa më sipër, zmadhimi i kapitalit nuk do të zvogëlojë pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveç se kur të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

9.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

Neni 10

Transferimi i kapitalit. Kufizimet mbi transferimin

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

-
- 10.2 Nëse një ortak vdes bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njih si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 10.3 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës të ky person tjetër.
- 10.4 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblenë e Ortakëve.
- 10.5 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim:

Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës të ortakërisë, ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim i cili duhet të përcaktojë dhe kushtet e transferimit.

Ortakët e shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga njoftimi. Në rast se asnjë prej ortakëve nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të përcaktuar më sipër, atëherë ortakët që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek të tretët kuotën e tij.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyre solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi vendimarrës

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

- 11.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“Asambleja e Ortakëve”), të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet

drejtuese , të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.

11.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
- c. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
- d. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- e. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- f. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- g. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
- i. të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
- m. të vendosë pagën e Administratorit;
- n. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- o. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- p. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- q. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- r. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- s. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtën rend dite.

Neni 12

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

12.1 Vendimet, të listuara më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 75 % të ortakëve prezentë ose të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit të parashikuara në Nenin 14 më poshtë (“**Shumicë e Kualifikuar**”). Të gjitha vendimet e tjera

të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të zakonshme të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit në Nenin 14 më poshtë (“Shumicë e Zakonshme”). Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për caktimin e administratorit miratohen me Shumicë të Zakonshme.

Neni 13

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 13.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t’u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t’u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 13.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërive Tregtare.

Neni 14

Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve, Kuorumi

- 14.1 Në rastin e vendimeve të miratuara me Shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët me të drejtë vote që kanë më shumë se 30% të kuotave të nënshkuara.
- 14.2 Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë Shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike,
- 14.3 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërish në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 14.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 14.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që ai të formalizohet me shkrim.

-
- 14.6 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 15

Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve

- 15.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 15.2 Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Kryetari i Asamblesë së Ortakëve do të zgjidhet nga ortakët e pranishëm në Asamblenë e Ortakëve, me Shumice të Thjeshtë para fillimit të asamblesë, ndërsa mbajtësi i procesverbalit do të caktohet nga kryetari i Asamblesë së Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbali të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është e nevojshme caktimi i mbajtësit të procesverbalit dhe nënshkrimi i procesverbalit nga kryetari i mbledhjes. Esktraktet e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve për qëllim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve ose nga Administratori i Shoqërisë.

Neni 16

Përfashtimi nga e drejta e votës

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Ortakëve merr vendime për:
- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- dhe çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17

Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit


- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga administratori, te emëruar në përputhje me këtë statut.
- 17.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të

justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në cdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit

- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

- 17.4 Administrator i Shoqërisë për një afat 5 vjeçar me te drejte rinovim do te emerohet:

Znj. Jeta HYSA, shtetas shqiptar, lindur më 17.10.1985 në qytetin e Gramshit dhe banues në Tiranë, ne adresen rruga Muharem Butka, Pallati Rinia 04, Shk B, Ap 22, Njesia Administrative Nr 5, shtetase shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me karte identiteti, te leshuar nga Ministria e Brendshme me nr. I 56017042 Q Shqipëri, me speciment nënshkrimi 

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

- 17.4 Administratoret ka të drejtat dhe detyrimet te veprojnë si me mëposhtme:
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pa miratim me shkrim nga ortakët;
 - nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori nuk do te kenë kufizim.
 - mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
 - punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pa miratimit me shkrim nga ortakët;
 - marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
 - administratoret ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura

nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

- j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- o. Administratorët janë të detyruar të therrasin asamblenë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyre tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
 - shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- p. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- q. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve , i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- r. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

KREU IV VITI FINANCIAR

Neni 18 Viti Financiar dhe Dividendi

-
- 18.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.
- 18.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave së nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

Neni 19

Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

- 19.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.
- 19.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 20

Bilanci, Mbajtja e Llogarisë

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 20.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Cilësuar.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Cilësuar:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë ;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 22

Largimi dhe përjashtimi i Ortakut

Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 24

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 25
Ndryshimet në Statut

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 26
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 27
Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku i shoqërisë tregtare “K & H CONSULTING” sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKU I VETEM
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“K & H CONSULTING” SH.P.K

Znj. JETA HYSA

